



**FEDERATA E TENISIT E KOSOVËS
TENISKA FEDERACIJA KOSOVA
KOSOVO TENNIS FEDERATION**

Në bazë të paragrafit 13.3 të Statutit të Federatës së Tenisit të Kosovës të datës 24 nëntor 2018, Bordi i Federatës në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2019 miraton këtë:

RREGULLORE NR. 2019-02

PËR

TARIFAT PËR ANËTARËSIM NË FEDERATË DHE PËR PJESËMARRJE NË TURNE



PËRMBAJTJA

1. Qëllimi.....	2
2. Tarifa për anëtarësi në Federatë.....	2
3. Tarifat për pjesëmarrje në turne	3
4. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera	3



1. Qëllimi

- 1.1. Përmes kësaj rregulloreje caktohet tarifa e anëtarësisë në Federatë për një vit kalendarik.
- 1.2. Njëkohësisht rregullohen edhe tarifat për pjesëmarrje në turnetë e Federatës.

2. Tarifa për anëtarësi në Federatë

- 2.1. Anëtarësimi në Federatë vlen për një vit kalendarik. Ajo mund të paguhet përmes transferit bankar në llogarinë e Federatës, ose para pjesëmarrjes në turne me para të gatshme tek drejtori organizativ i turneut. Ky i fundit obligohet t'i dorëzojë pagesat e anëtarësisë në Federatë.
- 2.2. Tarifat vjetore në fuqi nga data 1 janar 2019 janë:
 - 2.2.1. Klubet 50 EUR
 - 2.2.2. Trajnerët 10 EUR
 - 2.2.3. Referët 5 EUR
 - 2.2.4. Tenistët (të gjitha grupmoshat) 5 EUR
- 2.3. Në rast se tenisti (nën 2.2.4) paguan anëtarësinë në nëntor të një viti ajo pagesë do të vlejë edhe për tërë vitin e ardhshëm, përderisa pagesa nuk është pagesë e vonuar për vitin që ikën.
- 2.4. Për tenistët që për herë të parë marrin pjesë në garat e Federatës, krahas pagesës duhet dërguar në email adresën e Federatës edhe kopja (e skanuar) e një dokumenti të identifikimit apo e certifikatës së lindjes.
- 2.5. Për asnjërën nga këto pagesa nuk lëshohet kartelë identifikimi.
- 2.6. Klubet, trajnerët, referët ose tenistët që nuk e paguajnë anëtarësinë, nuk mund të përfitojnë nga përkrahja e Federatës apo të jenë pjesë e aktiviteteve që organizon Federata.



3. Tarifat për pjesëmarrje në turne

3.1. Tarifat në fuqi nga data 1 janar 2019 janë:

3.1.1. Grupmoshat ROG	5 EUR
3.1.2. Grupmoshat U12-U18	10 EUR
3.1.3. Kategoria “A”	15 EUR
3.1.4. Kategoritë “35+”	20 EUR

3.2. Pagesa e tarifës do t’i sigurojë lojtarit pjesëmarrje në turne, dhe së paku ujin e pijes nga organizatori.

3.3. Tarifat paraqesin të hyra për organizatorin e turneut.

3.4. Tenisti që nuk është tërhequr nga turneu brenda afatit të caktuar dhe përfundon pjesë e shortit të publikuar, obligohet për pagesë të tarifës për pjesëmarrje.

4. Dispozitat përfundimtare dhe të tjera

4.1. Kjo rregullore hyn në fuqi nga viti kalendarik 2019 e tutje.

4.2. Hyrja e saj në fuqi shfuqizon “Rregulloren për Pagesën e Anëtarësisë për Vitin 2015” të datës 12 prill 2015, si dhe të gjitha rregulloret apo vendimet e tjera të Bordit që janë në kundërshtim me të.

4.3. Interpretimi përfundimtar i kësaj rregulloreje është kompetencë e Bordit.

Mejdi Rexhepi

Kryetar

Federata e Tenisit e Kosovës

Prishtinë, 29 janar 2019